

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"E dimë shumë mirë çfarë bëri Egnatia", akuza të rënda nga Bekim Balaj: Vllaznia nuk ndjek atë rrugë për r kampion (E PLOTË)
ADRESA	https://www.balkanweb.com/e-dime-shume-mire-cfare-beri-egnatia-akuza-te-renda-nga-bekim-balaj-vllazna-nuk-ndjek-ate-rruge-per-kampion-e-plote/
BURIMI	balkanweb.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 11:54:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	4 shtator 2026, 13:23:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 4 shtator 2026, 13:22:00 UTC → 4 shtator 2026, 13:24:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	189ae9025e7b858a84743267b77a343b85f60dae95abdb09fccc71eb6e83a873
TEKSTI	c7c90cdd867bc00811a52e709e0af18d2369a03976614212c65d6b3e96a38cf
PAMJA	7999de3324e5f898760dfb75e86fc046bbb4601177daf0f75a5cb19175f878c9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ce0c3cd441635902b652272ac9b950736b80dfa8ba859147f2dbad270c6a5445
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e203f033d074a2d3c42a790e4ddfadf0e6c8e1c0300d49c3347be227adaa7f43
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te bllok, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ce0c3cd441635902b652272ac9b950736b80dfa8ba859147f2dbad270c6a5445>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



FILLIMI

SHQIPËRIA

KOSOVA

RAJONI

SPORT

BOTA

KULTURË

METROPOL

ANALIZA

TEKNOLOGJI

Fillimi > -Shqipëri

“E dimë shumë mirë çfarë bëri Egnatia”, akuza të rënda nga Bekim Balaj: Vllaznia nuk ndjek atë rrugë për kampion (E PLOTË)

04 Shtator, 2026 15:23



Madhësia e tekstit:



Kapiteni i Vllaznisë, Bekim Balaj, foli para ndeshjes që kuqeblutë do të luajnë me Partizanin. Ky takim është i vlefshëm për javën e tretë të kampionatit.

Balaj u ndal te titulli i fundit kampion që fitoi Egnatia. Në të njëjtën kohë nuk munguan akuzat e rënda, duke u shprehur se ekipet e tjera marrin fitoret dhuratë për të dalë nga vështirësia. Ndryshe ndodh te Vllaznia.

“Ajo ndeshja e fundit, të gjithë preken pak nga ajo frymë që u krijua. Mund të them se Vllaznia dhe Shkodra, në gjithë historinë e saj ka qenë dhe do jetë gjithmonë pro paqes dhe kundër dhunës në sport. Presidenti Xhaferi kërkoi falje në moment irritimi. Deri diku ishte reagim i akumuluar. Dalja e parë që bëhej pas atij sezoni, atij kampionati që humbëm. Normalisht përveç përgjegjësisë që kemi dhe duhet të marrim ne për atë kampionat që shkoi, reagimi në Elbasan tregon se kanë qenë edhe faktorë të tjerë në humbjen e atij kampionati. Nuk dua t'i prek ndeshjet me radhë, por më e freskëta ka qenë ndeshja ndaj Egnatias. Ai bërryl ndaj Gurishtës na dhemb akoma të gjithëve. Enea Jorgji dhe Juxhin Xhaja në VAR mendoj se kishin të gjitha mundësitë për të bërë zgjedhjen e duhur. Atë që panë të gjithë pasi loja



Kërko ketu

LAJMET E FUNDIT



Nuk ndalet aksioni qytetar! Protestuesit bllokojnë Rrugën e Elbasanit me kazanë mbeturinash. Shoqërohet “djali i pankartës”

17 Shtator, 2026



VIDEO/ Protestuesit përmbysin kazanët e mbeturinave para selisë së PD

17 Shtator, 2026



VIDEO/ Protestuesit nisin sërish marshimin drejt Kuvendit, ecin mes makinave

17 Shtator, 2026



Protestuesit “shkulin” gardhin metalik te Ministria e Brendshme, tentojnë të “çajnë” kordonin e policisë. Mbërrijnë “Shqiponjat”

17 Shtator, 2026



FOTO+VIDEO/ Tensionet para Ministrisë së Brendshme, protestuesit hedhin letra higjienike në drejtim të policisë. Një i shoqëruar

17 Shtator, 2026



LIVE- Qytetarët në çdo skaj të qendrës! Protestuesit marshojnë në sheshin Skënderbej, tensione në Bulevard

17 Shtator, 2026

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb



u ndalua për 10 minuta. Dalja e Gurishtës nga fusha me hundë të thyer dhe i pamundur për të luajtur, ndikoi përfundimisht në rezultatin e asaj ndeshje.

✕

Je i vetdijsëm kur bën një reagim të tillë. Moment tensioni dhe nga vendimet e arbitrit ndaj Elbasanit, pritej një vendim nga Disiplina. Jemi këtu për të dhënë shembull se Vllaznia dhe Shkodra janë gjithmonë kundër dhunës.

Jemi fokusuar te stërvitja. Te pjesa tekniko-taktike e ndeshjes së radhës, sado preket skuadra. Ta lëmë në një anë dhe të përqëndrohemi tek ajo që duhet të bëjmë dhe japin në fushë në këtë ndeshje.

Isha në periudhën e zëvendësimit, afër tij. Ai argumentonte, në bisedim me VAR, unë them goli i parë i rregullt dhe në fund lë 2 pikë.

Presidenti është afër skuadrës si gjithmonë. Ai veprim i presidentit mori me vete edhe dënimin personal të tij. Është mundur ta largojë skuadrën nga kjo situatë. Ekipi të ruajë qetësinë dhe të jetë i aftë të performojë sa më mirë në ndeshjen e radhës.

Pas dy barazimeve, na duhet fitorja. Pikët janë gjithmonë të rëndësishme. Në sezonin që shkoi 1 pikë do bënte diferencën, por e rëndësishme të performojmë mirë. Skuadra do vijë në rritje. Lojtarët e rinj që kanë ardhur do sinkronizohen me ekipin, me atë që kërkon trajneri. Shpresoj në rritje dhe të kthehem te 3 pikët.

Gurishta me eksperiencën dhe qetësinë e tij do na ndihmojë shumë në prapavijë. Lider i skuadrës për shumë vite dhe mungesa e tij është ndjerë.

Tension, me incidentet që ndodhën, por çdo fjalë dhe dalje e Vllaznisë që flet për arbitrat apo padrejtësi. Në Tiranë apo rëndom në media cilësohet sikur Vllaznia dëshiron të justifikojë dështimin e sezonit që shkoi. Vllaznia mund të jetë ekipi që ka folur më pak se të gjithë në sezonin që shkoi për arbitrimin. Kemi ekipin kampion që javë pas javë i dimë shumë mirë sulmet që ka bërë për arbitrimin. Me VAR dhe të gjithë arbitrat, braktisja e fushës në ndeshjen me Vllazninë. I vendosi në presion arbitrat, arriti të shpallej edhe kampion. Vllaznia nuk ndjek atë rrugë, e dimë që kemi qenë dhe do jemi gjithmonë vetëm kundër të gjithëve. Kështu ka ecur Vllaznia në gjithë historinë e saj, pa alenca dhe përkrahje dhe shpresoj t'ja dalim.

Shumë herë anashkalohet pjesa e fushës apo sporti në futbollin tonë.

Të gjithë jemi të vetdijsëm që duhet të kontribuojmë akoma më shumë, që futbollit të kthehet. Të gjithë jemi rritur në shkallët e stadiumit, i dimë pasionin apo dëshirën dhe entuziazmin që i ka sjellë futbollit Shkodrës, por edhe në tërësi Shqipërisë. Në vitet e fundit e

ndjen mungesën e prezencës së njerëzve në stadione. Atmosfera nuk është ajo që ka qenë. Si njerëz të sportit duhet të bëjmë maksimumin tonë që futbollit të kthejë entuziazmin. Me aq mundësi sa kemi duhet të kontribuojmë të gjithë. Ne, media, të gjithë njerëzit e sportit. Kemi një prirje që të evidentojmë anën e errët apo pjesën jashtë futbollit, që është dhe ka qenë gjithmonë prezente. Sporti duhet të jetë gjithmonë shembull uniteti, bashkimi dhe gëzimi për të gjithë sportdashësit.

Bandat? Ne nuk shqetësohemi, mundohemi që çdo gjë ta zgjidhim brenda kuadratit të fushës. Sado pak apo shumë faktorë që mund të jenë, siç thashë ne jemi mësuar Vllaznia të kalojë apo ecë me vështirësi. Nuk është rastësi që Vllaznia shkon 25 vite pa titull kampion. Pa hequr fajin apo përgjegjësinë që në gjithë këto vite kemi pasur ne si faktorë. Sot jam unë dhe shokët e mi, përpara kanë qenë edhe të tjerë. Nuk besoj se është rastësi pse Vllaznia nuk del kampion prej 25 vitesh. Një qytet që i ka dhënë kaq shumë futbollit. Si në shkallët e stadiumit me entuziazmin që krijon Vllaznia. Në njëfarë mënyre mund të them se futbollit shqiptar dhe të gjithë ato i kanë njëfarë borxhi Vllaznisë.

Unë jam kthyer me dëshirën maksimale për të dhënë më të mirën time të Vllaznia. Pjesa e titullit është diçka tjetër. Do apo s'do, këdo që ka veshur fanellën e Vllaznisë në këto vite i ka dhënë një peng. Për mua e rëndësishme ka qenë që të jap maksimumin, sa herë vesh fanellën e Vllaznisë.

Tifozeria ka qenë aty gjithmonë. Sa herë Vllaznia ka pasur nevojë, si në momentet e vështira që realisht ka pasur periudha që kemi luftuar për të qendruar në kategori. Dhe është mbushur stadiumi. Tifozeria ka qenë aty për të dhënë ndihmën e saj. Dhe në momentet e mira, janë mbështetje dhe do jenë gjithmonë për skuadrën.

Kampion? Herët për të thënë. Por që besoj se këtë pyetje mund ta kemi bërë për shumë vite, dhe përgjigjia ka qenë që Vllaznia do jetë gjithmonë aty. Për të pretenduar për ta fituar.

Besoj se jemi të vetdijshëm, edhe arsyet e humbjes së titullit, pa hequr përgjegjësinë që na takon për të marrë të gjithë që jemi faktorë. Jemi të vetdijshëm që rrugëtimin drejt titullit e kemi më të vështirë se çdo ekip në Superligë. Arsyet dihen. Vllaznia nuk ka qenë dhe as nuk është pjesë e asnjë aleance. Dhe sezonin që shkoi, një rrugëtim 40 javësh do kesh ulje-ngritje, por Vllaznia nuk ka pasur asnjë 3 pikë dhuratë që ta nxjerrë nga vështirësia. Siç mund t'i kenë marrë rëndom ekipet e tjera. Kjo është një ndër arsyet përse rrugëtimi ynë bëhet aq i vështirë drejt titullit. Duhet të jemi edhe më të fortë, përgatitemi për vështirësitë që na kanë dalë dhe do na dalin gjithmonë. Justifikimet nuk janë pjesë e imja. Vllaznia dhe Shkodra nuk i ka njohur asnjëherë justifikimet, kështu që do luftojmë fort", u shpreh Balaj.

Për t'u bërë pjesë e grupit **"Balkanweb"** mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

TË NGJASHME



Tabaku: "Balluku" dhe "Kayo" s'janë të izoluar, parlamenti përdoret për të mbrojtur korrupsionin

17 Shtator, 2026

17 Shtator, 2026

"Kushtetuesja do të vendosë për Kayo-n", Tabaku: Do të denoncojmë në institucionet ndërkombëtare. Hetim parlamentar si me "Inceneratorët"

TË FUNDIT NGA -SHQIPËRI

Spalletti-Amorim në dyshim, Conte qëndron në pritje

17 Shtator, 2026

Ndryshim programi, Maran fiton kohë, shtyn listën për të shtunën

17 Shtator, 2026

Krizë totale, Man.United përmbysen nga Brighton, del nga Carabo Cup, Carrick: Marr përsipër përgjegjësitë (VIDEO)

17 Shtator, 2026

Milan, zhgënjim total në Europë, Benfika i thyen në "Meazza", Amorim: Nuk krijojmë shumë

17 Shtator, 2026

Barça, një "tërmet 7 ballë", Raphinha i shënon "triletë" Racing, Flick: Fillim i bukur, por rëndësi ka si e mbyllim

17 Shtator, 2026

Nuk veshi fanellën pro Ceuta-s, Mbappe sqaron pozicionin e tij: Jam qenie njerëzore

17 Shtator, 2026

KATEGORIA VIDEO



Nuk ndalet aksioni qytetar! Protestuesit bllokojnë Rrugën e Elbasanit me kazanë mbeturinash. Shoqërohet "djali i pankartës"

17 Shtator, 2026



VIDEO/ Protestuesit përmbysin kazanët e mbeturinave para selisë së PD

17 Shtator, 2026



VIDEO/ Protestuesit nisin sërish marshimin drejt Kuvendit, ecin mes makinave

17 Shtator, 2026



Protestuesit "shkulin" gardhin metalik te Ministria e Brendshme, tentojnë të "çajnë" kordonin e policisë. Mërrin "Shqiponjat"

17 Shtator, 2026



FOTO+VIDEO/ Tensionet para Ministrisë së Brendshme, protestuesit hedhin letra higjienike në drejtim të policisë. Një i shoqëruar

17 Shtator, 2026



LIVE- Qytetarët në çdo skaj të qendrës! Protestuesit marshojnë në sheshin Skënderbej, tensione në Bulevard

17 Shtator, 2026



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.